

MasterCard me Këste pa Interes.

Lloji i Kartelës:

MasterCard me Këste pa Interes, është kartelë kreditore e cila mund të përdoret për blerjen e mallërave dhe shërbimeve në të gjitha POS терминаlet e NLB Bankë-s, të instaluar në dyqanet tregëtare, tërheqja e parave të gatshme në ATM si dhe pagesa përmes Internetit.

Gjithashtu mund të përdoret edhe në të gjitha POS-et dhe ATM-at e Bankave tjera brenda dhe jashtë Kosovës, që kanë shenjën e MASTER.

Karakteristikat dhe funksionaliteti i produktit MasterCard me Këste pa Interes:

- I mundëson Poseduesi i kartelës që borxhin ndaj bankës ta paguaj me këste deri në 36 muaj, **vetëm** kur blerja kryhet në POS-a të NLB Bankës dhe nëse ekziston paraprakisht një marrëveshje e nënshkruar në mes të Bankës dhe Tregtarit.
- Nëse blerja kryhet pa këste, transaksioni trajtohet si **Revolving**, me greis periudhë 45 ditë, ashtu që me datën 15 të muajit vijues, Poseduesi i kartelës do të ketë mundësinë që të paguaj tërë borxhin e shfrytëzuar ose së paku 5.00% të borxhit, të trajtuar si Revolving.
- Nëse Poseduesi i kartelës shfrytëzon kartelën për tërheqje të parave të gatshme në ATM, nuk ka greis periudhë, shuma e tërhequr nga ATM-i (borxhi i shfrytëzuar) nuk ndahet në këste por kalon në të arritur si dhe aplikohet përlllogaritja e interesit të arritur nga momenti i kryerjes së transaksionit deri në ditën e kthimit të mjeteve.
- Nuk ka limit minimal për blerje me kartelë, vetëm nëse Tregtari e përcakton ndryshe.
- Maksimumi i kësteve që ofron kartela është 36 këste, por varësisht prej Tregtarit numri i kësteve mund të jetë me i vogël.
- Përcaktimi i numrit të kësteve bëhet nga Poseduesi i kartelës me rastin e pagesës në POS të NLB Bankës, varësisht prej marrëveshjes me Tregtarin.
- Afati për pagesën e obligimeve të arritura është 15 ditë nga data e përlllogaritjes së të arriturave, përkatësisht prej datës 1 të muajit.
- Pagesa Minimale perbehet nga kësti/et që kalojnë në të arritura dhe/ose 5.00% e vlerës që trajtohet si revolving (nëse Poseduesi i kartelës blen pa këste apo bën tërheqje në ATM).
- Në rast se Poseduesi i kartelës e shfrytëzon limitin e kartelës kreditore për blerje në POS me këste dhe paguan në tërësi borxhin e përgjithshëm (këstin/et e arritura) brenda afatit, atëherë nuk aplikohet interesi i rregullt;
- Në rast se Poseduesi i kartelës e shfrytëzon limitin e kartelës kreditore për blerje në POS pa këste dhe paguan në tërësi borxhin e përgjithshëm (vlera totale e blerjes/ve) brenda afatit, atëherë nuk aplikohet interesi i rregullt;
- Në rast se Poseduesi i kartelës e shfrytëzon limitin e kartelës kreditore për blerje në POS pa këste dhe paguan vetëm 5.00% të borxhit të përgjithshëm (të vlerës së blerjes/ve) brenda afatit, atëherë do të aplikohet interesi i rregullt në borxhin e mbetur.
- Në rast se Poseduesi i kartelës e shfrytëzon limitin e kartelës kreditore për tërheqje të parave të gatshme nga ATM-i, atëherë do të aplikohet interesi i rregullt nga data e tërheqjes së mjeteve deri atëherë kur tërheqja në para të gatshme është paguar (kthyer) plotësisht.

- Shuma minimale për pagesë të borxhit përbëhet nga kësti/et që kalojnë në të arritura dhe borxhi totali i vlerës që trajtohet si revolving.
- Pagesa e tërësishme e borxhit bëhet vetëm me anë të parashtimit të kërkesës së Poseduesit të kartelës në bankë. Në këtë rast Stafi i Shitjes bënë kërkesën në BO ti kalojnë në të arritura këstet si dhe borxhin që trajtohet si revolving sipas kërkesës së Poseduesit të kartelës.

Shembull:

Nëse Poseduesi i kartelës e shfrytëzon kartelën kreditore **Master card me këste pa ineters** gjatë muajit Maj, atëherë periodha e shfrytëzimit të kartelës pa interes është data 15 e muajit Qershor (maksimum 45 ditë Grace periodhe).

Nëse Poseduesi i kartelës ka bërë tri blerje me kartelë (me këste) gjatë muajit Maj dhe këstet mujore janë 20€, 30€ dhe 40€, atëherë Poseduesi i kartelës, në muajin Qershor do të ngarkohet vetëm me një këst kumulativ 90€ (20€+30€+40€).

Nëse Poseduesi i kartelës perveq blerjeve me këste si më lartë, ka bërë blerje me kartelë (pa këste) në vlerë prej 100€, atëherë në muajin Qershor do të ngarkohet me 90€ këste si dhe 5.00% apo 5.00€ të blerjes me këste.

Nëse Poseduesi i kartelës perveq blerjeve me këste si më lartë dhe pa këste, ka bërë edhe tërheqje në ATM në vlerë prej 200€, atëherë në muajin Qershor do të ngarkohet me vlerën e kësteve 90.00€, me 5.00% të shumës së shfrytëzuar si Revolving si dhe 5.00% apo 10€ për vlerën totale të shumës së tërhequr nga ATM.

Bllokimi i kartelës ndodh nëse Poseduesi i kartelës nuk ka paguar shumat e cekura më lartë.

Debllokimi i kartelës bëhet në mënyrë automatike, vetëm pas pagesës së borxhit të arritur, interesit ndëshkues dhe vërejtjeve që Poseduesi i kartelës pranon (max. 2 vërejtje).

Ky proces zgjat më së shumti 24 ore.

Maturiteti

Limiti kreditor i kartelës kreditore MasterCard me Këste pa interes do të aprovohet në afat prej 3 vite.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit (i vërtetuar nga origjinali)
- Aplikacioni për kartelë kreditore (të cilin mund ta gjeni në intranet)
- Kontrata e punës valide
- Pengu mbi pagën i nënshkruar nga punëdhënësi
- CRK dhe profili i Poseduesit të kartelës.

MasterCard me Këste pa Interes

Limiti maksimal i kredit kartelës është **5,000.00 Eur**.

Limitet e blerjeve ditore

- Limiti ditor për blerje përmes POS-it është sa limiti i aprovuar
- Limiti ditor për tërheqje në para të gatshme (cash) në ATM - Max. 1,000 - 2,000 Eur varësisht nga limiti ditor i lejuar

Poseduesi i kartelës duhet ti drejtohet Bankës nëse ka kërkesë për rritje të limitit ditor për blerje.

Faturimi – Statement

Banka në fund të çdo muaji, përmes emailit i'a dorëzon Poseduesi të kartelës faturën (statement) për muajin përkatës, duke përfshirë qarkullimin gjatë tërë muajit, borxhin e arritur për pagesë si dhe afatin e pagesës.

Mënyra e pagesës

Detyrimet ndaj bankës Poseduesi i kartelës mund të paguaj në çdo kohë përmes :

- Sportelit
- Urdhëresës së përhershme
- E-Banking

Procedura në rast të mospagesës së borxhit të arritur

Poseduesi i kartelës është i obliguar që më së largu deri më datën 15 të muajit vijues, të paguaj borxhin e arritur, në të kundërtën pason bllokimi i përkohshëm i kartelës dhe i dërgohet vërejtja e parë.

Nëse Poseduesi i kartelës nuk paguan borxhin e arritur brenda 30 ditëve prej bllokimit të përkohshëm të kartelës, i dërgohet vërejtja e dytë.

Debllokimi i kartelës bëhet në mënyrë automatike, vetëm pas pagesës së borxhit të arritur, interesit ndëshkues dhe vërejtjeve që Poseduesi i kartelës pranon (max. 2 vërejtje).

Ky proces zgjat më së shumti 24 orë.

Nëse Poseduesi i kartelës nuk paguan borxhin e arritur edhe pas pranimit të vërejtjes së dytë, atëherë pason bllokimi i përhershëm i kartelës kreditore.

Mbyllja e pjesërisht apo e tërësishtme e kredit kartelës para afatit të maturimit

Poseduesi i kartelës ka të drejtë që në çdo kohë, të bëjë mbylljen e borxhit kredit kartelë MasterCard me keste pa interes.

Nëse Poseduesi i kartelës kërkon shlyerjen e pjesërishme të detyrimeve ndaj kredit kartelës, Stafi i shitjes është i obliguar që ta njoftoj se **Poseduesi i kartelës ka të drejtë të bëjë parapagimin e një blerje apo më shumë blerjeve në total.**

P.sh. nese Poseduesi i kartelës ka bërë një pagesë në POS në vlerë 300€ dhe kjo pagesa ndahet në 10 këste (p.sh. 30.00€ *10), si dhe një pagesë tjetër prej 500€ e cila ndahet në 12 këste (41.66€*12), atëherë banka do ti përlllogaritë vlerën e saktë të kësteve në vlera të plota e jo një pjesë të këstit apo vlera të pjesërishme.

Nëse prej pagesës së parë kane mbetë 4 këste në vlerë totale prej 120.00€ (30.00*4) dhe prej pagesës së dytë kanë mbetë tri këste në vlerë totale 124.98€ (41.66€*3) dhe kërkesa e Poseduesit të kartelës është që të paguaj 180€, atëherë Poseduesit të kartelës duhet që ti skjarohet se do ti mbyllet vlera 120.00€ dhe një këst prej pagesës së dytë në vlerë prej 41.66€, që në total bëjnë 161.66€ por jo shuma e kërkuar prej €180 nga Poseduesi i kartelës pasi që nga pagesa e dytë nuk ka mjete të mjaftueshme për ta shlyer vlerën totale por vetëm të një kësti. Pra nuk mund të paguhet vetëm një pjesë e këstit/eve por vetëm vlera totale e kësteve që në rastin konkret ai do të mund të paguan vlerën totale të pagesës së parë 120.00€ dhe 1 këst prej 41.66€ nga pagesa e dytë dhe i kthehet prapa shuma prej 18.34€.

ÇMIMORJA PËR MASTER COMFORT KARTELËS

Lloji i provizionit		Shuma	
Lëshimi i kartelës (rilëshimi pas skadimit)		Pa Pagesë	
Mirëmbajtja mujore		1.50 €	
Pasqyra mujore e llogarisë		Pa Pagesë	
Tërheqja në ATM	NLB Banka ATM	2.00% minimum 3.00 €	
	NLB Group ATM		
	ATM të huaj	2.00% minimum 5.00 €	
Provizioni për pagesa në POS të NLB dhe Internet		0.00 %	
Provizioni për pagesa në POS të Bankave tjera në Kosovë		0.00 %	
Provizioni për pagesa në POS të Bankave tjera jashtë Kosovës		0.00 %	
Provizioni i këmbimit valutor		1.00 %	
Provizioni për kthim të parave prapa (chargeback)		20.00 €	
Normat e interesit për blerje në POS dhe tërheqje në ATM		Me këste	Pa këste
Norma nominale e interesit	ATM tërheqje	N/A	24.00 %
	POS blerje	0.00%	24.00 %
*Norma efektive e interesit (periudha 12 mujore)	ATM tërheqje	N/A	26.82%
	POS blerje	0.00%	26.82%
Interesi ndëshkues ditor		0.08%	
Kërkesa për PIN të ri		2.50 €	
Kartela për persona të autorizuar		5.00 €	
Ndërrimi i kartelës në rast të dëmtimit, humbjes dhe vjedhjes së kartelës		5.00 €	
Vërejtja e parë		5.00 €	
Vërejtja e dytë		10.00 €	

Mirëmbajtja mujore për Kartelën Master me Këste i merret Poseduesit të kartelës kreditore në mënyrë automatike pas aktivizimit të kartelës. Shuma maksimale në dispozicion të klientëve për tërheqje me kartelë gjatë 24 orëve është deri në 500€.

¹Norma Efektive e Interesit (NEI) – paraqet totalin e kostos së kreditë kartelës (borxhin kryesorë dhe interesin e rregullt) e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredit kartelës së dhënë duke marr parasysh edhe vlerën e parasë në kohë.

$$NEI = \left(1 + i/12\right)^m - 1$$

i = Norma nominale e interesit vjetor

m = Numri i muajve

i = 24%

m = 12

$$NEI = \left(1 + 0.24/12\right)^{12} - 1$$

$$= \left(1.02\right)^{12} - 1$$

$$= 1.2682 - 1$$

$$= 0.2682 \text{ ose } 26.8$$